



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 0693067738

E-mail: [rmuca@klsh.org.al](mailto:rmuca@klsh.org.al); Web-site: [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)

### Auditim performance: "BURIMET ALTERNATIVE TË ENERGIJË NË SHQIPËRI"

#### Përmbledhje Ekzekutive

Në zbatim të planit vjetor 2015, Kontrolli i Lartë i Shtetit, në kuadër të përmbushjes së funksionit të tij Kushtetues, zbatimit të Udhëzimeve dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI, EUROSAI etj.), sipas shkresës nr. 904/1, dt. 19.01.2015, program auditimi, ndërmori auditimin me temë "Burimet Alternative të Energjisë në Shqipëri", paralel me vendet e tjera si Kosova, Turqia, Mali i Zi, Bosnja dhe Hercegovina etj., nën drejtimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO- Swedish National Audit Office-Riksrevisionen), duke u fokusuar në burimet alternative të energjisë elektrike, kryesisht asaj diellore.

Ky auditim u programua për t'u ushtruar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN). Sipas skemës organizative të MEI-t, një nga Drejtoritë e Përgjithshme të saj është ajo e Planifikimit Strategjik për Energjinë. Kjo e fundit krahas disa drejtorive të tjera, ka në varësi Drejtorinë e Burimeve Energjetike të Rinovueshme dhe Eficiencës Energjetike, si dhe Drejtorinë e Politikave dhe Zhvillimit Elketroenergjetik, të cilat lidhen drejtpërdrejt me politikën energjetike të rinovueshme që janë objekt i këtij auditimi të performancës. Veç kësaj, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore është e organizuar në disa drejtori, dy prej të cilave: Drejtoria e Energjive të Rinovueshme, si dhe Drejtoria e Hidroenergjetike kanë për objekt të punës së tyre pikërisht burimet e rinovueshme të energjisë.

Rritja në vazhdimësi e konsumit të lëndëve djegëse fosile me pasoja në ndryshimet klimatike globale dhe paqëndrueshmëria e furnizimit me energji elektrike, si rezultat i varësisë së plotë nga prodhimi hidrik, niveli i lartë i çmimeve të burimeve aktuale energjetike etj., kanë bërë që të kërkohet gjithnjë e më shumë shfrytëzimi i burimeve të energjisë së rinovueshme, si një element thelbësor i kuadrit të politikave kombëtare të energjisë.

Në vendin tonë, vazhdon të ruhet e njëjta strukturë e furnizimit me burime primare energjetike, me një nivel të pamjaftueshëm diversifikimi dhe kapacitet ekzistues gjenerues të pamjaftueshëm për të përballuar kërkesën për energji elektrike.

Veç kësaj, Shqipëria ka nënshkruar Traktatin themelues të Komunitetit të Energjisë me Komunitetin Evropian më 25.10.2005 dhe për pasojë është e detyruar për të arritur objektivat e BE-së për energjinë e rinovueshme të ripërtërishme të energjisë dhe treguesit e objektivave për energji efikase.

Në përfundim të punës audituese në terren, me shkresën nr 904/2 datë 30.06.2015 iu dërgua projekt-raporti i auditimit subjekteve të audituara, mbi bazën e të cilit është hartuar në afatin ligjor Raporti përfundimtar. Mbi bazën e Vendimit të Kryetarit të KLSH-së, nr. 113 prot., datë 09.09.2015, janë dërguar rekomandimet përkatëse dhe raporti përfundimtar MEI-t dhe AKBN-së me shkresat përkatëse nr. 904/10 prot., dhe nr. 904/11 prot., datë 11.09.2015.

Në përfundim, pasi Kryetari shqyrtoj Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projekt-vendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Performancës, shpjegimet e dhëna nga subjektet e audituara, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i

Drejtorisë Juridike dhe Zbatimit të Standardeve, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Kryeaudituesi dhe Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të nenit 15, shkronja “c” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”:

## K O N K L U D O I:

### **Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).**

Ekonomia e vendit në këtë situatë delikate të ekonomisë botërore, sidomos asaj të Eurozonës, por edhe e gjithë shoqëria shqiptare kanë nevojë për përdorimin me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve dhe pronës publike apo shtetërore. Problemet më të rëndësishme me të cilat përballet aktualisht dhe do të vazhdojë dhe në të ardhmen zhvillimi ekonomik i vendit dhe sektori energjetik në veçanti, janë rritja e konsumit të energjisë për banorë dhe mbajtja në të njëjtën kohë e një niveli relativisht më të ulët të intensitetit të energjisë, të cilat kërkojnë nxitjen e një ekonomie efikente dhe konkurruese.

Për Shqipërinë ku 20 - 23% e totalit të burimeve primare sigurohen nga energjia hidrike, përdorimi i energjive të tjera të rinovueshme është i rëndësishëm, sepse jo vetëm përmirëson sigurinë e furnizimit me energji dhe qëndrueshmërinë e sektorit të energjetikës, por edhe zvogëlon deficitin e tregtisë së jashtme për importimin e saj. *Nisur nga pozicioni gjeografik, me një klimë tipike mesdhetare, kemi burime të konsiderueshme të energjive të rinovueshme, të cilat mund të shfrytëzohen jo vetëm për zvogëlimin e kontributit të energjisë elektrike nga burimet konvencionale, por dhe për përfitimin e energjive të tjera të pastra.* vazhdon të ruhet e njëjta strukturë e furnizimit me burime primare energjetike, me një nivel të pamjaftueshëm diversifikimi dhe kapacitet ekzistues gjenerues të pamjaftueshëm për të përballuar kërkesën për energji elektrike

Rritja në vazhdimësi e konsumit të lëndëve djegëse fosile me pasoja në ndryshimet klimatike globale dhe paqëndrueshmëria e furnizimit me energji elektrike, si rezultat i varësisë së plotë nga prodhimi hidrik, niveli i lartë i çmimeve të burimeve aktuale energjetike etj., kanë bërë që të kërkojë gjithnjë e më shumë shfrytëzimi i burimeve të energjisë së rinovueshme, si një element thelbësor i kuadrit të politikave kombëtare të energjisë.

Gjithashtu, KLSH vazhdon me intensitet modernizimin e veprimtarisë audituese edhe nëpërmjet formave të tilla si auditimet paralele nën drejtimin e SAI-eve homologe që janë të përparuar në auditimet e performancës, si dhe për çështje që janë më tipike ose paraqesin interes për rajonin, duke përfutur nga eksperiencat e përbashkëta.

Krahas objektivit të përgjithshëm të auditimit të performancës për të evidentuar dhe ndërgjegjësuar nëpërmjet rekomandimeve nëse po bëhen gjërat e duhura në mënyrën dhe kohën e duhur, *objektivi specifik këtij auditimi është që duke analizuar kuadrin ekzistues rregullator, performancën e zbatimit të politikave institucionale publike nga Ministria e Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore për rritjen e përdorimit të burimeve alternative të energjisë, të arrihet në përfundime mbi përmirësimin e qëndrueshmërisë, nëpërmjet prodhimit dhe përdorimit me efektivitet të potencialit të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike në mënyrë miqësore me mjedisin.*

Gjatë kryerjes së këtij auditimi, jemi përpjekur t'i japim përgjigje pyetjes: *A ka ndërmarrë Qeveria iniciativa/veprime të mjaftueshme për përmirësimin e qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike, duke përdorur burime të rinovueshme?, dhe në përfundim ka arritur në këtë Mesazh auditimi:*

**“Megjithëse Shqipëria ka kryer jo plotësisht përafrimin e legjislacionit sipas kërkesave të BE-së dhe ka hartuar Draft-Planin Kombëtar të Veprimit të Burimeve të Rinovueshme dhe Eficencës së Energjisë, nuk ka arritur të përmirësojë**

qëndrueshmërinë e furnizimit me energji elektrike, pasi: Strategjia Kombëtare e Energjisë nuk është monitoruar dhe zbatuar sipas skenarëve përkatës; Plani Kombëtar i Veprimit prej më se tre vitesh nuk është miratuar akoma; ligji për burimet e rinovueshme vazhdon të jetë në proces përditësimi edhe pas më shumë se dy vitesh pa aktet e tjera nënligjore; si dhe kanë munguar iniciativat publike në këtë fushë për shkak të performancës së dobët të MEI-t dhe AKBN-së nga mungesa e financimeve buxhetore dhe ndarjes e dublikimit të kompetencave administrative brenda dhe midis tyre”.

Nisur nga konkluzionet mësipërme dhe rezultatet e punës audituese, duke synuar përmirësimin e mëtejshëm të këtij sektori Kryetari i KLSH-së:

## **V E N D O S I:**

**I.** Të miratojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të Performancës “Burimet Alternative të Energjisë në Shqipëri”, të ushtruar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë (MEI) dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore (AKBN).

**II.** Të miratojë rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave për sa vijon:

### ***1. Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë.***

1. Ministria e Energjisë dhe Industrisë të bashkëpunojë me institucionet e tjera qendrore për transpozimin e plotë të Direktivës në ligj, si dhe më pas vënien në zbatim të ligjit për burimet e rinovueshme, së bashku me të gjithë infrastrukturën përkatëse nënligjore, për të nxitur prodhimin dhe përdorimin e burimeve të rinovueshme të energjisë, në funksion të rritjes së sigurisë së furnizimit me energji elektrike të popullatës.

***Deri më 30.12.2015***

2. MEI të marrë masat e nevojshme dhe të bashkërendojë punën përfundimin e hartimit të Strategjisë Kombëtare të Energjisë të bazuar në situatë reale dhe në një kohë sa më të shpejtë, duke përcaktuar objektiva, detyra dhe perspektiva të qarta, të detajuara në afate, kosto dhe institucione respektive përgjegjëse për zbatimin e tyre. Gjithashtu të realizojë ngritjen e një strukture të posaçme për të monitoruar zbatimin e saj, nevojën për përditësim dhe bazën e nevojshme statistikore duke përcaktuar burimet e rinovueshme të energjisë potencial i veçantë natyror në rritjen e sigurisë së furnizimit me energji elektrike dhe zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

***Deri më 30.12.2015***

3. MEI të marrë masat e nevojshme dhe të bashkërendojë punën për përfundimin e hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit të Burimeve të Rinovueshme dhe Eficiencës së Energjisë, në një kohë sa më të afërt, duke bërë të mundur harmonizimin e tij me të gjithë zhvillimet e fundit dhe përmirësimet e kuadrit rregullator në sistemin energjetik.

***Deri më 30.10.2015***

4. MEI të marrë masat e nevojshme dhe të bashkërendojë punën për të rishikuar ligjin 138/2013 për burimet e rinovueshme, jo vetëm për ta harmonizuar me kuadrin rregullator dhe zhvillimet e fundit në sektorin energjetik shqiptar, por dhe transpozimin e plotë të Direktivës 2008/29/EC; diversifikimin dhe krijimin e mundësive për përdorimin e të gjitha potencialeve

natyrore të burimeve të rinovueshme të energjisë, si dhe një harmonizim më të mirë të interesave dhe nxitje të investitorëve dhe përdoruesve familjarë të burimeve të rinovueshme të energjisë në tërësi dhe asaj elektrike në veçanti.

***Deri më 30.10.2015***

5. MEI të marrë masat e nevojshme dhe të bashkërendojë punën që të sigurojë plotësimin e objektivit të BE-së për të arritur në vitin 2020 përdorimin e 38 % të energjisë nga burimet e rinovueshme, duke e konsideruar këtë edhe si objektiv kombëtar, në mënyrë të qëndrueshme duke përfshirë jo vetëm energjinë hidrike, por edhe atë diellore dhe të erës, si dhe përdorimin në transport të bioakrburanteve në masën prej 10 %, në kuadër të forcimit të sigurisë kombëtare në fushën energjetike, por dhe të përmirësimit të treguesve mjedisor.

***Vazhdimisht***

6. MEI të rishikojë prioritet e saj, duke i kushtuar një vëmendje të posaçme diversifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nëpërmjet shfrytëzimit të potencialeve natyrore të burimeve të rinovueshme, kryesisht asaj diellore, në funksion jo vetëm të rritjes së qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike dhe shfrytëzimit optimal të rezervës hidroenergjetike, por edhe të ruajtjes së mjedisit natyror të vendit.

***Vazhdimisht***

7. MEI të marrë masa për të rritur shpenzimet buxhetore në mbështetje të burimeve të rinovueshme të energjisë veçanërisht në sektorin publik, si dhe të rishikojë strukturën organizative, rolin dhe përgjegjësinë e Drejtorive për fuqizimin e prodhimit dhe përdorimit të energjive të rinovueshme në tërësi dhe atyre elektrike në veçanti, në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë së furnizimit me energji elektrike të vendit.

***Vazhdimisht***

8. MEI të bashkërendojë dhe të harmonizojë veprimtarinë e projekteve, pavarësisht burimit të financimit, midis Drejtorive brenda ministrisë, jo vetëm në shkëmbimin e të dhënave, hartimin e rrugëve të zhvillimit etj., në funksion të rritjes së eficiencës së projekteve, por dhe të sinergjizimit të veprimtarive në kuadër të rritjes së kapaciteteve gjeneruese të energjisë elektrike në vend.

***Vazhdimisht***

## **II. Për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë dhe Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.**

9. Ministria e Energjisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore të përditësojë Draftin aktual të Planit të Veprimit për Burimet e Rinovueshme, t'ja paraqesë për shqyrtim Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë dhe të kryejë finalizimin me miratimin e tij, në një kohë sa më të shpejtë, jo vetëm që të shmang penalizimin nga ky organizëm, por dhe të ndikojë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

***Menjëherë***

10. Ministria e Energjisë dhe Industrisë në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore, të sigurojë miratimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë, duke ridimensionuar konceptin për burimet e rinovueshme, në funksion të plotësimit të objektivit të BE-së për përdorimin e tyre, duke ndikuar në zhvillimin e

qëndrueshëm dhe sigurinë e furnizimit me energji elektrike të vendit.

*Menjëherë*

11. MEI dhe AKBN të marrin masat e nevojshme që sëbashku me hartimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare të Energjisë, të bashkërendohen me planet kombëtare të veprimit për energjitë e rinovueshme dhe kuadrin rregullator përkatës (ligje, vendime, udhëzime) të detajuara me afate, kosto dhe institucione përgjegjëse, në përputhje me kërkesat e direktivave të BE-së, zhvillimeve të deritanishme në fushën energjetike dhe perspektivës së zhvillimit të vendit.

*Vazhdimisht*

### **III. Për Agjencinë Kombëtare të Burimeve Natyrore.**

12. AKBN, në zbatim të detyrave të veta të përcaktuara me VKM nr. nr. 547, datë 09.08.2006 “Për krijimin e AKBN”, të ndryshuar, të bashkëpunojë më mirë me Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë, për të siguruar hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e Dokumenteve Strategjike (Strategji Kombëtare e Energjisë, Plane Kombëtare Veprimi etj.) në fushën energjetike, përfshirë dhe burimet e rinovueshme, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm të vendit.

*Vazhdimisht*

13. AKBN, të marrë masat e nevojshme për të bërë një ndarje të qartë me përgjegjësi dhe detyra konkrete sipas konceptit të BE-së për burimet e rinovueshme të energjisë, në funksion të zbatimit të nxitjes dhe zgjerimit të prodhimit dhe përdorimit të burimeve të rinovueshme të energjisë elektrike, duke ndikuar në përmirësimin e furnizimit me energji elektrike të vendit.

*Deri më 30.12.2015*

14. AKBN të marrë masa për sigurimin e burimeve financiare të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë studimore, hartuese, zbatuese dhe monitoruese të politikave dhe dokumenteve strategjike në fushën e burimeve të rinovueshme, duke aktivizuar kapacitetet dhe përvojën e specialistëve dhe nëpunësve të këtij institucioni, për një rol aktiv në përdorimin me efektivitet të burimeve natyrore.

*Vazhdimisht*

15. AKBN të marrë masa që të sigurojë një informacion të përditësuar në lidhje me koston dhe eficiencën e përdorimit të energjisë diellore për të sensibilizuar konsumatorët dhe biznesin në përfitimet nga prodhimi dhe përdorimi i energjisë diellore, si dhe të hartojë një program masash për të siguruar të dhënat statistikore thelbësore në fushën e burimeve të rinovueshme, përfshirë dhe ato për energjinë elektrike.

*Vazhdimisht*

#### *Grupi i auditimit*

Gjovalin Preçi

Andi Buzo

Gentjan Leva

Artan Topjana

Drejtori

Rinald Muça

Tiranë, shtator 2015